



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*  
Zyra për Qeverisje ë Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

# RAPORT VJETOR



**PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-të NË KUADËR  
TË INSTITUCIONEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2017**

Maj, 2018

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>LISTA E SHKURTESAVE</b> .....	3
<b>1. HYRJE</b> .....	4
1.1 Metodologjia e përdorur .....	6
<b>2. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA TË PAVARURA</b> .....	8
<b>3. TË DHËNA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA</b> .....	11
3.1 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të Ministrive .....	11
3.1.1 Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga ministritë.....	12
3.1.2 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i Ministrive dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare .....	13
3.2 Mbështetja në kuadër të Komunave .....	16
3.2.1 Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga komunat.....	16
3.2.2 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i komunave dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare .....	19
3.3 Mbështetja financiare publike nga Agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera publike .....	21
<b>4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b> .....	22
<b>5. ANEKSE: LISTA E PËRFITUESVE SIPAS INSTITUCIONEVE DHE SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR VITIN 2017</b> .....	24
ANEKSI 1 - LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË MINISTRIVE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2017 .....	25
ANEKSI 2 - LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË KOMUNAVE PËR VITIN 2017 .....	52
ANEKSI 3 - LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË AGJENCIVE DHE ORGANIZATAVE TJERA BUXHETORE PËR VITIN 2017 .....	75
ANEKSI 4 - SHEMBULLI I NJË RAPORTI I KOMUNËS SË SHTIMES, I PLOTËSUAR NË MASË TË MADHE SIPAS KËRKESAVE TË RREGULLORES .....	78

## LISTA E SHKURTESAVE

AACK	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I KOSOVËS
AKP	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
ARH	AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE
ARSHU	AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
ASHAK	AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ASHNA	AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR
ASHNA	AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR
IGJK	INSTITUTI GJYGJËSOR I KOSOVËS
KPMM	KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE
KQZ	KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE
KRPP	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
MAP	MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
MAPL	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MASHT	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MBPZHR	MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MD	MINISTRIA E DREJTËSISË
MeD	MINISTRIA E DIASPORËS
MF	MINISTRIA E FINANCAVE
MFSK	MINISTRIA E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS
MI	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MIE	MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN
MKK	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
MKRS	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
MKRS	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
MMPH	MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MPB	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MPJ	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
MPMS	MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENJES SOCIALE
MSH	MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MTI	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIISË
MZHE	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
OJQ	ORGANIZATA JO-QEVERITARE
SHSKUK	SHËRBIMI SPITALOR KLIKIK UNIVERZITAR I KOSOVËS
UP	UNIVERSITETI I PRISHTINËS
ZKA	ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
ZKM	ZYRA E KRYEMINISTRIT
ZP	ZYRA E KRYEMINISTRIT
ZRRE	ZYRA E RREGULLATORIT TË ENERGJISË SË KOSOVËS

## 1. HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komunitetet lokale edhe gjatë vitit 2017 kanë vazhduar me përkrahjen e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare në fusha të ndryshme, me prioritet për Institucionet e Republikës së Kosovës dhe shoqërisë kosovare. Kjo mbështetje financiare e projekteve të OJQ-ve kishte për qëllim rritjen e bashkëpunimit me Shoqërinë civile, veçanërisht me Organizatat Joqeveritare. Duhet theksuar se me përkrahjen edhe të donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë, gjatë vitit 2017 është punuar shumë në përmirësimin e vendimmarrjes, përmes procesit të konsultimeve publike ku organizatat jo qeveritare dhe shoqëria civile kanë një rol të konsiderueshëm.

Qeveria po ashtu, me ndihmën e donatorëve dhe me pjesëmarrjen e organizatave jo qeveritare për herë të parë arriti të hartoj legjislacionin sekondar, i cili në mënyrë të qartë përcakton kriteret, standardet dhe procedurat e mbështetjes financiare publike për organizatat jo-qeveritare. Ministria e Financave dhe Zyra për Qeverisje të Mirë me përkrahjen e Projektit të Asistencës Teknike të Komisionit Evropian *“Përkrahje për Implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile”* kanë hartuar Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të, së bashku me metodologjinë e monitorimit dhe raportimit dhe manualin për zbatimin e saj. Këto dokumente janë konsultuar me të gjitha institucionet publike dhe organizatat jo qeveritare. Po ashtu, janë zhvilluar edhe konsultime publike dhe gjatë hartimit janë marrë përbazë një numër i madh i komenteve të cilat janë inkorporuar në këtë legjislacion sekondar.

Më 1 korrik të vitit 2017 Rregullorja MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve ka hyrë në fuqi dhe njëjta është publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.<sup>1</sup> Kjo rregullore përcakton rregulla sipas të cilave financimi publik i OJQ-ve do të bëhet në mënyrë transparente, mbi bazën e kriterëve të paracaktuara, në mënyrë konkurrencte e ku publiku do të informohet në mënyrë transparente për përfituesit dhe prioritetet e financuara përmes parasë publike. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2017 vlerëson në mënyrë pozitive miratimin e këtij legjislacioni sekondar, ku thekson se *“Hyrja në fuqi e dy rregulloreve që përcaktojnë standardet për konsultimin dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për financimin publik të OJQ-ve ka hapur rrugën për përmirësim të qeverisjes dhe përmirësimin e përdorimit më transparent të fondeve publike.”*<sup>2</sup> Raporti vë në dukje po ashtu nevojën për përmirësim të kapaciteteve institucionale për të vepruar në përputhje me kërkesat e reja, duke theksuar se *“disa ministri dhe komuna ende nuk janë të*

<sup>1</sup> Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14831>

<sup>2</sup> Kosovo 2018 Report, f. 9, available at: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

*gatshme për të përmbushur detyrimet sipas rregulloreve të reja.” Dhe se “ende ka mungesë të kapaciteteve teknike për të ekzekutuar në mënyrë efektive buxhetin e caktuar në pajtim me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara”<sup>3</sup>*

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit për herë të parë publikoi Raportin për Mbështetjen financiare publike që përfshinte vitet 2015 dhe 2016 në mars të vitit 2017. Ky mandat i është dhënë zyrës për Qeverisje të Mirë me Rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Publikimi i raportit të tillë ka marrë një vlerësim pozitiv edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2017, i cili thekson se *“Në mars të vitit 2017, Qeveria publikoi raportin e parë mbi financimin publik. Kjo përbën një hap pozitiv drejt një transparence më të madhe të financimit publik.”*<sup>4</sup> Raporti, po ashtu vë në dukje që informacioni i publikuar duhet të përmbaj më shumë informacion. *“Megjithatë, lloji i informacionit të siguruar nuk lejon ende një analizë domethënëse të ekzekutimit të buxhetit”*<sup>5</sup>

Rregullorja e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2017, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar informacionin që institucionet publike duhet të raportojnë lidhur me financimin publik të OJQ-ve. Për më tepër aty janë përcaktuar edhe formularët standard të raportimit. Rregullorja ka përcaktuar po ashtu rolin e Zyrës për Qeverisje të Mirë në procesin e përgatitjes së Raportit Gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, i cili përgatitet mbi bazën e raporteve të të gjitha institucioneve publike. Prandaj, me miratimin e legjislacionit mbi kriteret dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të, edhe forma e monitorimit dhe raportimit për mbështetjen financiare publike për OJQ-të është shumë më e strukturuar.

Raporti mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të për vitin 2017, është raporti i dytë i pagatitur në nivel të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me mbështetjen financiare publike për OJQ-të, dhe mbulon të gjitha organizatat buxhetore, të nivelit qendror dhe lokal të cilat në çfarëdo forme kanë ofruar mbështetje financiare për organizatat jo qeveritare. Duke pas parasysh që Rregullorja MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve ka hyrë në fuqi më 1 korrik të vitit 2017, ende është e vështirë të nxirren konkluzione të sakta lidhur me zbatimin e plotë të kërkesave të rregullores nga ana organizatave buxhetore. Megjithatë, ekzistojnë shembuj pozitiv, të implementimit të kërkesave të rregullores nga ana e organizatave buxhetore. Nga komunikimi me organizatat buxhetore, vërehet se ato kanë filluar me zbatimin më të plotë të kërkesave të rregullores duke filluar nga viti fiskal 2018.

---

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Kosovo 2018 Report, f. 9, available at: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

<sup>5</sup> Po aty.

Sa i përket raportimit dhe bërjes së qasshme të financimit publik për OJQ-të për vitin 2017 nga ana e Organizatave Buxhetore, konsiderojmë se i njëjti lë hapësirë për përmirësim në të ardhmen. Në kohën kur ky raport gjithëpërfshirës u përpilua, shumica e organizatave buxhetore ende nuk i kanë publikuar raportet mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2017 në ueb faqet e tyre, dhe po ashtu, një numër i madh i tyre nuk i kanë dorëzuar tek Zyra për Qeverisje të Mirë në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017. Megjithatë, shumë nga organizatat buxhetore i kanë përgatitur dhe dorëzuar raportet e tyre. Si rrjedhojë, edhe këtë vit, Zyra për Qeverisje të Mirë, me qëllim që publiku të informohet sa më mirë lidhur me mbështetjen financiare publike për Organizatat jo Qeveritare, ka bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, gjegjësisht me Thesarin në mënyrë që të përgatitet një raport gjithëpërfshirës bazuar në pagesat që organizatat buxhetore kanë ekzekutuar për përfituesit të cilët janë regjistruar në Thesar si Organizata Jo-Qeveritare. Publikimi i këtij raporti vlerësojmë se do të kontribuojë rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike dhe në të njëjtën kohë do të ketë ndikim në përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile në Republikën e Kosovës. Besojmë se raporti i ardhshëm mbi financimin publik të OJQ-ve do të jetë shumë më i avancuar, duke pas parasysh që Rregullorja MF-Nr. 04/2017 ka filluar të implementohen në mënyrë më të plotë nga fillimi i vitit 2018.

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënie së institucioneve publike si dhe krijimin e besimit të ndërsjellë mes shoqërisë civile dhe institucioneve publike. Prandaj, përgatitja dhe publikimi i këtij raporti është në këtë funksion.

## **1.1 Metodologjia e përdorur**

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ka kërkuar të nga të gjitha organizatat buxhetore që të përgatisin dhe dorëzojnë raportet mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2017. Megjithatë, duke pas parasysh që një numër i madh i organizatave buxhetore nuk kanë arritur të dorëzojnë raportet e tyre në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, Zyra për Qeverisje të Mirë ka përdorur si bazë të dhënat e siguruar nga ane Thesarit në Ministrinë e Financave. Prandaj, Raporti për mbështetjen financiare publike për OJQ-të në kuadër të institucioneve të Republikës e Kosovës për vitin 2017, është përgatitur mbi bazën e të dhënave të siguruar nga Ministria e Financave, përkatësisht Thesari. Të dhënat e siguruar nga Thesari përfshijnë të gjitha pagesat që janë ekzekutuar brenda periudhës 1 janar- 31 dhjetor të vitit përkatës për furnitorët e regjistruar në Thesar si Organizata Jo-Qeveritare. Këto të dhëna më tutje janë strukturuar sipas ministrive, komunave dhe agjencive tjera dhe të njëjtat u janë dërguar institucioneve përkatëse për ti validuar, përkatësisht për të dhënë komentet e tyre.

Komentet e institucioneve janë analizuar në veçanti sa i përket asaj nëse ka pasur thirrje publike ose jo për mbështetjen e tillë, dhe për aq sa ka qenë e mundur të shihen objektivat e mbështetjes financiare të tillë. Megjithatë, jo të gjitha organizatat buxhetore, janë përgjigjur dhe kanë komentuar mbi të dhënat e dërguara.

Duke pasur parasysh se të dhënat e siguruara nga Ministria e Financave janë mbi bazën e pagesave dhe jo të projekteve apo programeve të financuara, për përgatitjen e këtij raporti të dhënat e tilla janë përpunuar, në atë mënyrë që, nëse një OJQ ka pranuar shuma të ndryshme të parave brenda një viti nga i njëjti institucion apo nga departamente të ndryshme të të njëjtit institucion, ato janë mbledhur dhe janë paraqitur si një shumë e vetme financiare për të njëjtën OJQ brenda vitit përkatës në anekset e bashkangjitura të këtij raporti.

Ndonëse, projekte të caktuara në kuadër të institucioneve të ndryshme mund të jenë aprovuar me shuma më të larta se sa ato të paraqitura në këtë raport pasi jo të gjitha shumatat e aprovuara mund të jenë ekzekutuar brenda vitit fiskal, për të ruajtur njëtrajtshmërinë e metodologjisë së të dhënave të përdorura, në këtë raport janë paraqitur vetëm shumatat e ekzekutuara dhe të raportuara nga Thesari. Duke pas parasysh që Rregullorja MF-Nr. 04/2017 ka hyrë në fuqi në pjesën e dytë të vitit 2017, besojmë se në raportet e ardhshme, duke përfshirë raportin e vitit 2018, do të jenë më të plota.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrës së Kryeministrit është mbështetur nga projekti i Asistencës Teknike të financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë *“Përkrahje për Implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile”*. Zyra për Qeverisje të Mirë dhe ekipi i Projektit *“Përkrahje për Implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile”* nuk mban përgjegjësi për saktësinë e shënimeve përkitazi me emërtimet e OJQ-ve apo faktin nëse emrat e furnitorëve të regjistruar nga Thesari dhe të raportuara si organizata jo qeveritare dhe të paraqitura në këtë raport janë Organizata Jo Qeveritare të Regjistruara sipas ligjit në fuqi. Emërtimet janë paraqitur ashtu siç janë pranuar nga Thesari.

## 2. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA TË PAVARURA

Nga të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2017, mund të konstatojmë se bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare në realizimin e prioriteteve qeveritare në fusha të ndryshme ka vazhduar me të njëjtin intenzitet. Edhe gjatë vitit 2017 institucionet e nivelit qendror dhe lokal kanë vazhduar mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve të Organizatave jo-qeveritare, duke përfshirë financimin e projekteve specifike, apo përkrahjes direkte për OJQ-të dhe projektet e tyre.

Mbi bazën e të dhënave financiare për vitin 2017 të siguruar nga Thesari në Ministrinë e Financave, të dhëna të cilat bazohen në pagesat e kryera përmes sistemit të *freebalance* del se mbështetja financiare publike e transferuar tek OJQ-të nga institucionet publike duke përfshirë institucionet qendrore (Kuvendi, Presidenca, Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë), agjencitë e pavarura dhe komunat për vitin 2017 është rreth 16,029,756 euro. Kjo shumë, është e përafërt duke pas parasysh faktin se në disa raste organizatat apo projekte të caktuara mund të jenë paraqitur në kuadër të këtyre pasqyrave pa qenë organizata jo-qeveritare.




Figura 1. Të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2017

Nëse bëjmë një krahasim e të dhënave të financimit publik të projekteve të OJQ-ve për vitin 2017 me ato të vitit paraprak 2016 shohim një rritje të përgjithshme të financimit të OJQ në



vitin 2017. Kjo rritje kryesisht vërehet në nivel të institucioneve qendrore, ndërsa të dhënat e vitit 2017 tregojnë për një rënie të financimit prej rreth 1 milion euro në nivel të komunave. Grafi në vijim paraqet në mënyrë krahasuese të dhënat e mbështetjes financiare publike për OJQ-të në Kosovë për vitet 2016-2017 për të gjitha organizatat buxhetore, të ndarë sipas ministrive, komunave dhe agjencive tjera:




Figura 2. Të dhënat krahasuese për financimin publik të OJQ-ve 2016-2017

Edhe gjatë vitit 2017 një numër i madh i OJQ-ve ka përfituar mbështetje financiare publike për projektet e tyre si në nivel të organizatave buxhetore qendrore ashtu edhe në nivel të komunave. Krahasuar me vitin 2016, në vitin 2017 vërehet një rënie e numrit të OJQ-ve përfituese. Në vitin 2017 në nivel të Ministrive kanë pranuar mbështetje financiare 594 OJQ, ndërsa në vitin 2016 mbështetje financiare kishin pranuar rreth 711 OJQ përfituese. Këto të dhëna tregojnë se në vitin 2017, nivel të ministrive kemi një rënie të numrit të OJQ-ve përfituese të mbështetjes financiare publike me rreth 116 OJQ, krahasuar me vitin 2016.

Në nivel të komunave numri i OJQ-ve përfituese është më i lartë se sa në nivel të ministrive. Gjatë vitit 2017 nga buxheti i të gjitha komunave kanë përfituar gjithsej 813 OJQ. Sidoqoftë, edhe në nivel të komunave kemi një rënie të numrit të OJQ-ve që kanë përfituar mbështetje financiare publike në krahasim me vitin 2016. Të dhëna të paraqitura në këtë raport janë përgatitur mbi bazën e të dhënave të siguruar nga ana e Thesarit në Ministrinë e Financave,

dhe si të tilla paraqesin çdo formë të mbështetjes financiare e cila ka shkuar për furnitorët të cilët në Thesar janë të regjistruar si Organizata Joqeveritare.

Në kuadër të agjencive tjera, të cilat kryesisht i raportojnë kuvendit, kemi një rritje të numrit të OJQ-ve që kanë përfituar nga mbështetja financiare publike. Në vitin 2017 kanë pranuar mbështetje financiare publike 18 përfitues, përderisa në vitin 2016 ishin 12 përfitues.

Njëri nga faktorët, që ka mundur të ketë ndikuar në rënien e numrit të OJQ-ve përfituese në nivel të ministrive dhe të komunave mund të jetë edhe hyrja në fuqi rregullore MF-Nr. 04/2017. Siç theksuam më sipër kjo rregullore ka përcaktuar kritere dhe procedura të cilat Organizatat Buxhetore janë të obliguara ti respektojnë me rastin e ofrimit të mbështetjes financiare publike për OJQ-të. Prandaj, një rënie e numrit të OJQ-ve përfituese të mbështetjes financiare mund të interpretohet edhe si një shenjë e fillimit të respektimit të kritereve dhe procedurave të parapara me këtë rregullore.

Grafi në vijim tregon në mënyrë krahasuese numrin e përfituesve të mbështetjes financiare publike nga ministrinë, komunat dhe agjencitë tjera për vitet 2016-2017:




Figura 3. Numri i OJQ-ve që kanë pranuar mjete financiare nga organizatat buxhetore 2016-2017

### 3. TË DHËNA PËR MBËSHJETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA

#### 3.1 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të Ministrive

Të dhënat e paraqitura në vijim tregojnë shumën e mbështetjes financiare publike për OJQ-të sipas ministrive përkatëse e cila është ofruar në vitin 2017, dhe e njëjta është krahasuar edhe me vitin paraprak. Në disa nga ministrinë kemi rritje të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, ndërsa në disa tjera kemi një rënie të lehtë. Nëse i analizojmë të dhënat e mbështetjes financiare publike, mund të konstatojmë se sa i përket shumës së mbështetjes financiare, institucionet që më së shumti kanë përkrahur projektet e OJQ-ve janë Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, Ministria e Bujqësisë, ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Arsimit etj. Figura 4, në vijim paraqet në mënyrë grafike të dhënat e mbështetjes financiare publike për OJQ-të në nivel të Ministrive, Zyrës së Kryeministrit dhe Zyrës së Presidentit për vitin 2017 të krahasuara me vitin paraprak 2016.




Figura 4. Shuma e mbështetjes financiare publike në nivel të Ministrive 2016-2017

### 3.1.1 Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga ministrinë

Zyra për Qeverisje të Mirë u ishte drejtuar të gjitha Ministrive për të raportuar mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të të realizuar gjatë vitit 2017. Krahas kërkesës, Zyra për Qeverisje të Mirë kishte përcjellë edhe formularët standard të raportimit. Megjithatë, vetëm një numër i vogël i ministrive kanë raportuar në formatin e kërkuar. Përveç kësaj, nga institucionet që kanë raportuar, vetëm një numër i vogël i tyre, kanë përcjellë informatat në mënyrë të standardizuar dhe me përshkrimet e duhura sa i përket projekteve të financuara, objektivave dhe përfituesve.

Nga Ministrinë si shembull pozitiv mund të përmendet **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**, e cila në raportimin e saj ka përshkruar edhe objektivat e mbështetjes financiare për OJQ-të, të cilat kryesisht janë mbështetur nga fusha e shërbimeve sociale, përkujdesjes shëndetësore dhe po ashtu për OJQ-të të cilat mbështetin kategori me nevoja të veçanta të shoqërisë. Një pjesë e madhe e kësaj mbështetje financiare është ofruar përmes thirrjes publike, ndërsa pjesa tjetër është ofruar mbi bazën e mbështetjes së drejtpërdrejtë të bazuar në kërkesat individuale të përfituesve.

Edhe **Ministria e Diasporës**, ka dorëzuar një raport më të plotë në krahasim me institucionet tjera. Edhe kjo ministri, ka raportuar se mbështetjen financiare publike për OJQ-të e ka implementuar sipas një thirrje publike. Në kuadër të kësaj ministrie, shumica e projekteve të mbështetura kanë qenë të ndërlidhura me diasporën, duke përfshirë, aktivitete, kulturore, sportive, letrare etj.

Në kuadër të **Ministrisë së Shëndetësisë**, kryesisht janë mbështetur Organizatat jo Qeveritare që ndërlidhen me profesione të caktuara shëndetësore. Përveç kësaj, një pjesë e madhe e financimit është implementuar në bashkëpunim edhe me komunat në ofrimin e shërbimeve shëndetësore nga disa Organizata Jo Qeveritare. Ministria e Shëndetësisë ka raportuar se projektet e mbështetura kryesisht kanë të bëjnë me përkujdesje shëndetësore shtëpiake dhe ambulatore, aftësinë e kufizuar, gratë, fëmijët. Objektivat kryesore të gjithë mbështetjes kanë qenë të ndërlidhura me ruajtjen dhe përparimin e shëndetit. Kjo ministri nuk ka hapur ndonjë thirrje publike për financimin e këtyre projekteve, por të njëjtat janë financuar mbi bazën e kërkesës.

Raportin e ka dorëzuar edhe **Ministria e Zhvillimit Ekonomik**, e cila kryesisht ka mbështetur disa aktivitete që ndërlidhen me fushën e ekonomisë. Megjithatë, raporti i dorëzuar nuk ka përmbajtur të gjitha të dhënat e kërkuara. Edhe **Ministria e FSK-së** ka raportuar lidhur me financimin e OJQ-ve, dhe që kryesisht kemi të bëjmë me blerje të shërbimeve trajnuese nga përfituesit që janë të regjistruar si organizata jo qeveritare. **Ministrinë tjera, nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre për të raportuar sipas kërkesave të Rregullores MF-Nr. 04/2017.**

Edhe pse, të dhënat e siguruar nga Thesari në Ministrinë e Financave dhe po ashtu të dhënat e tjera të qasshme nuk kanë qenë të plota për të kuptuar qëllimin e mbështetjes financiare publike, si dhe objektivat e mbështetjes, nga ato të dhëna që Zyra për Qeverisje të Mirë kishte

në dispozicion shihet se mbështetja financiare publike deri diku është në linjë me objektivat strategjike dhe fushën e përgjegjësisë së institucioneve/ministrive që ofrojnë këtë mbështetje financiare publike. Zyra për Qeverisje të Mirë me qëllim të informimit të publikut ka analizuar të dhënat e të gjitha pagesave të kryera nga ana e këtyre institucioneve dhe mbi bazën e atyre të dhënave bazike në dispozicion mund të konstatoj se shumica e Ministrive kanë mbështetur OJQ-të në fushën e tyre të përgjegjësisë dhe prioritetëve. Megjithatë ekzistojnë edhe raste të mbështetjes financiare për OJQ-të, ku përkrahja nuk ndërlidhet drejtpërdrejtë me fushën e përgjegjësisë së institucioneve të cilat ofrojnë mbështetjen financiare.

Në kuadër të **Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**, vërehet se mbështetja më e madhe ka shkuar në drejtim të federatave dhe klubeve sportive të sporteve të ndryshme. Federatat dhe klubet sportive në Kosovë janë të regjistruara si OJQ, prandaj, edhe në këtë raport janë paraqitur si organizata jo qeveritare. Në kuadër të kësaj ministrie janë mbështetur edhe një numër i madh i OJQ-ve të cilat kanë implementuar projekte nga fusha e kulturës, artit, etj.

**Zyra e Kryeministrit**, ka mbështetur kryesisht OJQ-të të cilat kanë implementuar projekte në fusha të ndryshme përfitues i të cilave kanë qenë OJQ-të që vijnë nga komunitetet pakicë në Republikën e Kosovës, në veçanti nga komuniteti serb. Në kuadër të zyrës së kryeministrit, janë zhvilluar thirrje publike kryesisht nga Zyra për Çështje të Komuniteteve. Është me rëndësi të theksohet se **Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit** në fund të vitit 2017 ka implementuar një thirrje publike për financim të projekteve nga fusha e mbrojtjes nga diskriminimi. Gjatë implementimit të kësaj thirrje janë respektuar në tërësi kërkesat e rregullores. Sidoqoftë, meqë thirrja ishte kompletuar në fillim të vitit 2018, raporti i ardhshëm do të përfshijë në detaje praktikat dhe përvojat lidhur me zbatimin e rregullores përkitazi me këtë thirrje.

Duke pasur parasysh që mbi bazën e të dhënave në dispozicion, është e vështirë të bëhet një dallim në mes të projekteve dhe programeve të financuara dhe përkrahjes direkte apo kontraktimit për ofrimin e shërbimeve apo blerjes së nga ana e OJQ-ve, në kuadër të këtyre të dhënave janë të përfshira edhe shërbimet e kontraktuara, duke përfshirë shërbimet e edukimit, trajnimit etj, të ofruara nga organizatat e regjistruara si organizata jo-qeveritare. Për shembull shumë nga institucionet qendrore kanë paguar për shërbimet që janë paguar për trajnim Universitetit Amerikan në Kosovë, i cili është i regjistruar si organizatë jo qeveritare. Po ashtu, trajnimet në fushën e kontabilitetit, dhe auditimit janë të përfshira pasi organizatat që i kanë ofruar të njëjtat janë regjistruar si organizata jo-qeveritare.


### **3.1.2 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i Ministrive dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare**

Në figurën 5 në vijim, është paraqitur numri i OJQ-ve përfituese në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Ministrive dhe Presidencës. Të dhënat e mëposhtme janë të përpunuara në atë mënyrë që ndonëse në shumë raste OJQ-të kanë pranuar më shumë se një herë pagesa nga të

njëjtat institucione, në figurën në vijim janë paraqitur të dhënat e përpunuara për numrin e përfituesve në kuadër të secilës ministri, që nënkupton se edhe në rastet kur një OJQ ka përfituar më shumë se një herë brenda vitit, për qëllimet e raportit konsiderohet si një OJQ përfituese. Kjo nënkupton se në kuadër të shumës mund të jetë mbështetur më shumë se një projekt brenda vitit.

Nga figura shihet se numri më i madh i organizatave përfituese janë në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Zyrës së Kryeministrit, Zyra e Kryeministrit, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së arsimit etj. Më së shumti OJQ kanë përfituar nga Ministria e Kulturës rinisë dhe Sporteve, nga e cila kanë përfituar 365 organizata jo qeveritare, pasuar nga Zyra e Kryeministrit me 77 OJQ përfitues, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me 75 OJQ përfituese, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me 45 OJQ përfitues e kështu me radhë.

Kështu, nga mbështetja financiare publike për OJQ-të, e ofruar në nivel të Ministrive, për vitin 2017 kanë përfituar mbështetje financiare 594 OJQ, dhe siç u theksua më sipër kemi një rënie të numrit të OJQ-ve përfituese krahasuar me vitin paraprak për rreth 115 OJQ përfituese. Shumica e OJQ-ve që kanë përfituar mbështetje financiare në vitin 2017, kanë pranuar mbështetje edhe në vitet paraprake. Në tabelën në vijim është paraqitur numri i OJQ-ve përfituese nga fondet publike për vitin 2017 sipas secilës ministri. Për qëllime krahasimi kemi përfshirë edhe të dhënat e numrit të përfituesve nga viti paraprak.



**Figura 5. Numri i OJQ-ve përfituese sipas Ministrive për vitet 2016-2017**

Nga analiza e të dhënave të përpunuara për mbështetjen financiare publike për OJQ-të të ofruar nga Ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës mund të vërehet se numri më i madh i organizatave jo qeveritare kanë përfituar shuma deri në 5,000 euro. Nga numri total prej 594 OJQ-ve përfituese në 2017, rreth 400 OJQ kanë pranuar shuma më të vogla se 5,000 euro. Shuma nga 5,000 deri në 10,000 euro kanë përfituar 92 organizata jo qeveritare. Shuma prej 10,000 deri në 20,000 euro kanë përfituar gjithsej 45 organizata jo qeveritare.

Në figurën në vijim janë paraqitur në mënyrë grafike të dhënat lidhur me numrin e OJQ-ve përfituese sipas shumave përkatëse, dhe në të njëjtën kohë është bërë krahasime edhe me vitin paraprak.




Figura 6. Numri i OJQ-ve përfituese sipas shumave specifike në kuadër të ministrive

### 3.2 Mbështetja në kuadër të Komunave

Në vitin 2017 Kosova ka gjithsej 38 komuna, të cilat janë organizata buxhetore në kuptimin e ligjit për menaxhimin e financave publike. Nga këto 38 komuna, 37 prej tyre kanë dhënë mbështetje financiare publike për Organizatat jo-qeveritare në vitin 2017. Të dhënat nga Thesari në Ministrinë e Financave tregojnë se në vitin 2017 janë transferuar gjithsej 6,052,311 Euro në llogaritë e Organizatave jo- Qeveritare nga ana e Komunave. Nëse bëjmë një krahasim të shumës së financimit publik për projektet e OJQ-ve nga komunat në vitin 2017 me ato të vitit 2016, vërehet një rënie e financimit të Organizatave jo Qeveritare në nivelin komunal me mbi 1.1 milion euro në vitin 2017. Figura në vijim paraqet mbështetjen financiare publike sipas secilës nga komunat për vitin 2017, duke bërë krahasimin me vitin paraprak.




Figura 7. Mbështetja financiare publike për OJQ-të nga komunat 2016-2017

#### 3.2.1 Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga komunat

Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM duke u bazuar në kërkesat e rregullores MF-Nr. 04/2017, përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar nga komunat veç e veç që të raportojnë lidhur me mbështetjen financiare publike që kanë ofruar gjatë vitit 2017. Megjithatë, edhe përkundër njoftimit për kërkesat ligjore dhe kërkesës që të publikojnë dhe dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raportet sipas kërkesave të Rregullores jo të gjitha komunat



kanë raportuar në formën e kërkuar sipas rregullores MF-Nr. 04/2017. **Rreth 30 komuna nuk kanë dorëzuar raportet në përputhje me kërkesat e rregullores MF-Nr. 04/2017.** Një numër i komunave , gjithsej 8 komuna kanë raportuar në formën standarde të raportimit. Në vijim, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur disa nga objektivat si dhe fusha në të cilën janë mbështetur projektet e OJQ-ve **në komunat raportuese.** Duke pas parasysh që ishte hera e parë që kërkohej një raportim i tillë sipas kërkesave të rregullores, ekzistojnë shembuj pozitiv të raportimit tek komunat raportuese.

**Komuna e Shtimes** ka dorëzuar raportin e saj mbi financimin publik të OJQ-ve në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017. Raporti është plotësuar në masën më të madhe në të gjitha kolonat e kërkuara. Nga të dhënat e raportuara vërehet se shumica e mbështetjes financiare publike është ofruar në formë të mbështetjes direkte dhe përmes vendimeve të organeve të komunës. Nuk është raportuar për thirrje publike për financimin e projekteve të OJQ-ve. Shumica e projekteve të mbështetura janë të ndërlidhura me fushën e sportit, kulturës dhe rinisë. Përveç kësaj një numër i projekteve janë të ndërlidhura me fushën e bujqësisë, dhe zhvillimit ekonomik. Kurse disa projekte kishin për qëllim mbështetjen e personave me nevoja të veçanta. Shumica e projekteve dhe përfituesve të raportuara nga ana e Komunës së Shtimes korrespondojnë me të dhënat e financimit publik të siguruara nga Thesari.

**Komuna e Graçanicës** ka raportuar lidhur me mbështetjen financiare të ofruar gjatë vitit 2017. Kjo komunë ka përfshirë të dhënat kyçe sa i përket financimit publik të OJQ-ve, duke përfshirë edhe aktivitet kryesore. Në këtë drejtim, vërehet se janë mbështetur kryesisht projekte dhe aktivitetet të OJQ-ve të ndërlidhura me sportin, aktivitetet kulturore, promovimi i artit, promovimi i traditave të komunitetit që jeton në këtë komunë si dhe aktivitete të cilat janë ndërlidhura me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, etj. po ashtu vërehet se janë mbështetur edhe OJQ aktivitetet e të cilave janë të lidhura me sektorin e bujqësisë, mbrojtjen e kafshëve etj. Raporti i përgatitur nga kjo komunë, përmbante informacionin e mjaftueshëm për të kuptuar fushat e mbështetjes financiare, përfituesit si dhe aktivitetet e financuara.

**Komuna e Podujevës** gjithashtu ka përgatitur dhe dorëzuar raportin e saj, i cili përmban listën e OJQ-ve përfituese nga mbështetja financiare publike, së bashku me fushat e mbështetjes. Raorti nuk ishte i plotësuar në tërësi, por përmbante të dhënat kyçe sa i përket financimit. Nga të dhënat e dorëzuara vërehet se shumica e projekteve të mbështetura nga ana e kësaj komune janë të ndërlidhura me fushën sportit, artit dhe kulturës, aktivitetet e lira, si dhe fusha e shërbimeve sociale. Edhe në kuadër të komunës së Podujevës, shumica e mbështetjes financiare është ofruar duke u bazuar në vendimet e organeve të komunës dhe pa zhvilluar thirrje publike.

Në raportin e **Komunës së Suharekës** janë përfshirë shumica e kërkesave për raportim, duke përfshirë përfituesin, shumën, emrin e projektit si dhe qëllimin e ofrimit të mbështetjes financiare. Nga këto të dhëna mund të vërehet se shumica e financimit të ofruar nga kjo komunë për OJQ-të ka të bëjë me mbështetjen për klubet sportive, ndërsa një numër i aktiviteteve kanë të ndërlidhura me kulturën, artin, arsimin si dhe çështjet e komuniteteve.

Nga raporti i pranuar nga **Komuna e Drenasit**, shihet se shumica e projekteve të financuara janë të ndërlidhura me sportet, kurse një numër i konsiderueshëm i projekteve i takojnë edhe fushës së artit dhe kulturës. Në raportin e pranuar, është theksuar se mbështetja është ofruar në mënyrë direkte, pra përmes vendimeve të institucioneve komunale dhe pa zhvilluar ndonjë thirrje publike. Ndërsa, në pjesën që ka të bëjë me përmbledhjen e aktiviteteve të mbështetura të dhënat nuk janë të plota. Kjo komunë ka raportuar që të gjitha projektet janë duke u zbatuar në përputhje me kontratën dhe të gjitha janë të zbatueshme për një periudhë kohore më të shkurtës se një vit.

**Komuna e Vushtrrisë** gjithashtu ka dorëzuar raportin e saj lidhur me financimin publik të OJQ-ve. Edhe në kuadër të kësaj komune vërehet se janë financuar një numër i konsiderueshëm e OJQ-ve që merren me fushën e sportit, duke përfshirë klubet e ndryshme sportive. Po ashtu, janë financuar edhe projektet e OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale. Përveç kësaj, në kuadër të kësaj komune janë financuar/bashkë financuar edhe projekte me OJQ të huaja. Disa nga projektet kishin për synim ofrimin e mbështetjes për kategori me nevoja të veçanta të shoqërisë. Komuna e Vushtrrisë nuk ka raportuar të ketë pasur thirrje publike, por kryesisht financimi është bazuar në vendimet e organeve të komunës.

**Komuna e Ranilugut** ka financuar një numër të vogël projekteve, kryesisht nga fusha e kulturës dhe sportit. Edhe në rastin e komunës së Ranilugut mbështetja financiare publike për OJQ-të është ofruar mbi bazën e vendimeve direkte dhe pa thirrje publike. Raporti i përgatitur nga kjo komunë ishte pjesërisht i plotësuar.

Përveç, të dhënave të raportuara nga ana e komunave, Zyra për Qeverisje të Mirë ka analizuar edhe të dhënat nga Thesari në Ministrinë e financave, për të nxjerrë një raport sa më gjithëpërfshirës lidhur me mbështetjen financiare publike për OJQ-të. Nga këto të dhëna të analizuara vërehet se kryesisht, në nivel komunal kontraktimi është bërë në mënyrë direkte, dhe mbi bazën e kërkesës së organizatave jo-qeveritare. Në shumë raste mbështetja është dhënë edhe me vendime të Kuvendit Komunal të komunave përkatëse. Sa i përket qëllimit të mbështetjes financiare kryesisht ajo ndërlidhet me sportin, kulturën, përkrahje për OJQ-të të cilat promovojnë zhvillimin lokal etj.

Edhe gjatë vitit 2017 nga analiza e të dhënave në dispozicion, vërehet se komunat kryesisht kanë mbështetur organizatat jo-qeveritare të cilat veprojnë në nivel komunal, pra brenda

territorit të komunës që ofron mbështetjen. Megjithatë, disa organizata jo-qeveritare që ushtrojnë veprimtarinë në një numër më të madh të komunave kanë përfituar nga më shumë se sa një komunë në Republikën e Kosovës. Sidoqoftë, nga disa prej komunave janë financuar edhe OJQ të cilat ushtrojnë veprimtarinë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në veçanti OJQ që merren me sport si dhe ato të cilat kanë për qëllim të mbështesin grupe të caktuara në nevojë të shoqërisë, duke përfshirë personat me nevoja të veçanta, OJQ-të që janë duke ofruar shërbime shëndetësore, OJQ-të të cilat janë duke implementuar projekte të cilat janë të bashkë-financuara me donatorët etj.

### 3.2.2 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i komunave dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare

Në nivel të Komunave në Republikën e Kosovës janë mbështetur një numër i madh i organizatave jo-qeveritare edhe gjatë vitit 2017. Krahasuar me vitin paraprak 2016, vërehet një rënie e numrit të përgjithshëm të organizatave jo qeveritare që kanë përfituar mbështetje financiare për projektet e tyre nga komunat. Përfitues të mbështetjes financiare publike janë një numër i madh i OJQ-ve të cilat kanë përfituar edhe në citin paraprak. Figura në vijim tregon në mënyrë grafike numrin e OJQ-ve të cilat kanë përfituar në secilën nga komunat gjatë vitit 2017. Me qëllim të krahasimit me vitin paraprak janë përfshirë edhe të dhënat për financimin gjatë vitit 2016.




Figura 8. Numri i OJQ-ve përfituese sipas komunave për vitet 2016-2017

Në të njëjtën mënyrë, sikurse edhe në nivelin Qendror, shuma më e madhe e OJQ-ve kanë përfituar shuma deri në 5,000 euro. Të dhënat tregojnë se sa më e madhe shuma e mbështetjes financiare, numri i OJQ-ve përfituese është më i vogël.




Figura 8. Numri i OJQ-ve përfituese në kuadër të komunave sipas shumave specifike

### 3.3 Mbështetja financiare publike nga Agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera publike

Edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Agjencitë e Pavarura kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve ose kanë pranuar shërbime nga OJQ-të gjatë vitit 2017. Në vitin 2017 shuma e transferuar nga këto institucione te OJQ-të ishte 286, 273 euro, ndërsa në vitin paraprak kjo shumë ishte 70, 974 euro. Kryesisht financimi për OJQ-të ka shkuar si pjesë e marrëveshjeve të drejtpërdrejta për ofrim të shërbimeve, ndërsa në raste të caktuara, veçanërisht nga Kuvendi janë mbështetur projekte specifike të OJQ-ve. Shih figurat në vijim:




Figura 9. Mbështetja për OJQ-të nga Kuvendi dhe agjencitë e pavarura 2015-2016




Figura 10. Numri i OJQ-ve përfituese nga Kuvendi dhe Agjencitë e Pavarura 2016-2017

#### 4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Rregullorja e Ministrisë së Financave MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve për herë të parë rregullon në mënyrë unike financimin publik të OJQ-ve për të gjitha organizatat buxhetore. Kjo rregullore ka bazën në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 53 i LMFPP-së thekson: *“Ministri është shprehimisht i autorizuar që të nxjerrë rregullat të cilat duhet të respektohen nga organizatat buxhetore ose autoritetet publike gjatë përzgjedhjes së pranuesit ose pranuesve si dhe përcaktimit të shumës ose shumave të cilat do të open në formë të grantit, donacionit ose subvencionit. Këto rregulla duhet të sigurojnë që procesi të ketë për qëllim arritjen e synimeve të Kuvendit kur i njëjti e ka autorizuar grantin, donacionin ose subvencionin përkatës në ligjin përkatës për ndarjet buxhetore.”*<sup>6</sup> Prandaj, institucionet publike, duhet të kenë parasysh që, moszbatimi i kësaj rregulloreje, drejtpërdrejtë do të mund të konsiderohet edhe mospajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili është legjislacioni kryesor në Fushën e Financave Publike në Republikën e Kosovës.

Rregullorja MF-Nr. 04/2017 përcakton kriteret dhe procedurën bazë për një financim transparent dhe të bazuar në kriteret të paracaktuara. Në të njëjtën kohë, përmes formularëve standard institucioneve iu është lehtësuar puna në përgatitjen e thirrjeve publike, vlerësimin e aplikimeve dhe zhvillimin e procedurave në tërësi. Kjo rregullore hyri në fuqi në korrik të vitit 2017, prandaj, edhe raportimi mbi përmbushjen e kriterëve të paracaktuara me këtë rregullore ndërlihet me periudhën e pas miratimit të saj. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, çdo akt tjetër nënligjor i cili ka rregulluar financimin publik të OJQ-ve nuk është i zbatueshëm në këtë fushë. Sidoqoftë, ky raport përfshinë gjithë vitin 2017, prandaj është e vështirë të bëhet një ndarje e financimit para hyrjes në fuqi të rregullores dhe atij pas hyrjes në fuqi të saj. Kjo pasi, shumica e institucioneve nuk kanë raportuar sipas kërkesave të rregullores deri më tani.

Zyra për Qeverisje të Mirë, gjatë procesit të përgatitjes së këtij raporti, është munduar që të mbledh gjithë informacionin e duhur sipas rregullores si dhe sa i përket zbatimit të rregullores. ZQM ua ka rikujtuar institucioneve publike detyrën për raportim dhe ka kërkuar nga to që të përgatisin dhe dorëzojnë raportet në formatin e kërkuar, ndonëse një detyrë të tillë të gjitha institucionet publike e kanë të përcaktuar me rregulloren e mësipërme. Prandaj, gjatë përgatitjes së këtij raporti, institucionet publike është dashur të raportojnë edhe nëse kanë zhvilluar thirrje publike me rastin e ofrimit të mbështetjes financiare publike për OJQ-të ose jo? Siç është raportuar më sipër, në disa raste nga raportet e pranuar nga komunat, është vërejtur se janë zhvilluar thirrje publike, ndërsa shumica e mbështetjes financiare është ndarë sipas vendimeve të organeve përkatëse të organizatave buxhetore dhe kontraktimit direkt, gjë që

---

<sup>6</sup> Neni 53, Par. 3, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Versioni Elektronik i qashtëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

bënë të mos ketë pasur një konkurrueshmëri të plotë me rastin e ofrimit të mbështetjes financiare publike.

Nga analiza e të dhënave të mbështetjes financiare Publike për OJQ-të për vitin 2017 shihet qartë që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera publike japin një mbështetje financiare të konsiderueshme për Organizatat Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës. Organizatat Jo Qeveritare përfituese janë nga të gjitha komunat e Kosovës, kjo duke pas parasysh edhe faktin që komunat marrin pjesë pothuajse në mënyrë të barabartë me sa i përket mbështetjes financiare publike për OJQ-të. Kur jemi tek mbështetja financiare publike për OJQ-të në nivel komunal, shumica e OJQ-ve përfituese ushtrojnë veprimtarinë në territorin e komunave nga të cilat ofrohet mbështetja financiare publike.

Për vitin 2017 vërehet një rritje e përgjithshme e financimit në kuptimin e shumës së financimit në nivel qendror, megjithatë, si tërësi nëse analizojmë numrin e përfituesve si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal kemi një rënie të financimit krahasuar me vitin paraprak. Kjo rënie mund të jetë e lidhur edhe me hyrjen në fuqi të rregullores MF-Nr. 04/2017, për shkak se zbatimi i kriterëve të rregullores kërkon një planifikim të duhur të mbështetjes financiare dhe përgatitje të thirrjeve publike.

Edhe gjatë vitit 2017, mund të konsiderojmë se nuk ekzistojnë të dhëna publike mbi monitorimin e projekteve dhe programeve të financuara të OJQ-ve. Për dallim nga viti paraprak, tek institucionet që kanë raportuar vërehet një përmirësim në të dhënat që kanë të bëjnë me emërtimin e projekteve si dhe aktivitetet e projekteve të financuara. Megjithatë, mbetet shumë punë dhe hapësirë për përmirësimin e raportimit. Në anën tjetër, institucionet publike të cilat nuk kanë raportuar fare, por edhe ato që kanë raportuar, duhet të përgatisin dhe të publikojnë sa më shpejtë raportin e tyre mbi financimin publik të OJQ-ve, sipas kërkesave të rregullores.

Institucionet publike duke përfshirë, ministritë, komunat dhe agjencitë e pavarura, duhet të rrisin transparencën lidhur me mbështetjes financiare publike, duke përgatitur dhe publikuar në uebfaqet e tyre raporte të rregullta vjetore mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të. Këto raporte do të duhej të përfshijnë ndër të tjera: a) Emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike (Ministrisë, komunës, agjencisë, duke përfshirë programet specifike në kuadër të të cilave ofrohet mbështetja financiare publike) b) Menynë e alokimit të mbështetjes financiare publike (përmes thirrjes/kontraktim direkt) c) Thirrjen publike përmes të cilës është ofruar mbështetja financiare; d) Emrin e plotë të përfituesve të mbështetjes financiare (duke përfshirë edhe të dhënat tjera të përfituesit, Adresën, Numrin e regjistrimit dhe Numrin fiskal dhe të dhënat për personin përgjegjës të OJQ-së;) e) Emërtimin e projektit/programit apo aktivitetëve të financuara; f) Shumën e dhënë për financimin e projektit/programit; g) Kohëzgjatjen e projektit dhe statusin e zbatimit të tij; h) Fushat e përgjithshme dhe specifike të financimit; i) Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë; j) Aktivitetet apo shërbimet kryesore të realizuara në kuadër të projektit; k) Të dhënat gjeografike sa i përket vendit të implementimit të projektit; l) Numrin e personave që kanë përfituar apo janë punësuar në

kuadër të projekti/programit. Për qëllim të raportimit standard duhet të përdoret formulari 20, i cili është pjesë përbërëse e rregullores.

Zyra për Qeverisje të Mirë planifikon që përmes projektit të Asistencës Teknike tu ndihmoj institucioneve publike në rritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në zbatimin e rregullores. Prandaj, gjatë vitit 2018, do të organizohen trajnime shtesë të përbashkëta, si dhe trajnime në vendin e punës të cilat ndër të tjera do të përfshijnë edhe ngritjen e kapaciteteve në raportimin e mbështetjes financiare publike. Institucionet inkurajohen të përzgjedhin stafin adekuat për të ndjekur këto trajnime, në mënyrë që në të ardhmen të zbatohen me përpikëri kërkesat e rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Institucionet publike duhet që të zbatojnë thirrje publike për secilën mbështetjes financiare publike për OJQ-të.

## **5. ANEKSE: LISTA E PËRFITUESVE SIPAS INSTITUCIONEVE DHE SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR VITIN 2017**



**ANEKSI 1 - LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHËTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË  
MINISTRIVE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2017**

<b>Nr.</b>	<b>INSTITUCIONI FINANCUES</b>	<b>OJQ PËRFITUESE</b>	<b>SHUMA E MBËSHËTETJES FINANCIARE</b>
	<b>ZYRA E KRYEMINISTRIT</b>		
1	ZYRA E KRYEMINISTRIT	ACTIVE DEVELOPMENT OF SOCIETY	12,000.00
2	ZYRA E KRYEMINISTRIT	AFA RUGOVA	9,510.00
3	ZYRA E KRYEMINISTRIT	AFRK	3,900.00
4	ZYRA E KRYEMINISTRIT	AMERIKAN UNIVERSITY IN KOSOVO	33,150.00
5	ZYRA E KRYEMINISTRIT	AS OJQ	6,000.00
6	ZYRA E KRYEMINISTRIT	AUG ASOCIJACIJA UJEDINJENIH GORANACA	2,700.00
7	ZYRA E KRYEMINISTRIT	AVENIJA	6,500.00
8	ZYRA E KRYEMINISTRIT	BALKAN SMILE OJQ	9,000.00
9	ZYRA E KRYEMINISTRIT	BOKSERSKI KLUB REAL ROM GRAC	2,000.00
10	ZYRA E KRYEMINISTRIT	BOLJA BUDUCNOST B B	4,000.00
11	ZYRA E KRYEMINISTRIT	BUSNISS SUPORT CENTER-BSC	4,800.00
12	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CED-E	6,000.00
13	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CENTAR RAZVOJA PRAVIH VREDNOST	7,550.00
14	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CENTAR ZA DEPOLITIZACIJU KOSOV	8,200.00
15	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CENTAR ZA MIR I TOLERANCIJU	3,000.00
16	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CENTAR ZA RAZVOJ GRADANSKOG DR	4,000.00
17	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CENTAR ZA RAZVOJ ZAJEDNICE PAR	6,000.00
18	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CENTAR ZA SOC INICIJATIVE CZSI	10,300.00
19	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CHOICE OF YOUTH	4,000.00
20	ZYRA E KRYEMINISTRIT	COMUNICATION FOR SOCIAL DEVELO	16,950.00
21	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CREATIVE HOUSE	700.00
22	ZYRA E KRYEMINISTRIT	CSCS	7,000.00
23	ZYRA E KRYEMINISTRIT	EQUAL TO EQUAL	3,000.00
24	ZYRA E KRYEMINISTRIT	ETNO IZVORI	4,000.00
25	ZYRA E KRYEMINISTRIT	EVROPSKA BUDUCNOST	3,000.00
26	ZYRA E KRYEMINISTRIT	EXPERIMENTAL STUDIO GROUP ESG	3,000.00
27	ZYRA E KRYEMINISTRIT	FEDERATA E SHAHUT TE KOSOVE	3,000.00
28	ZYRA E KRYEMINISTRIT	FORTESA OJQ	6,000.00
29	ZYRA E KRYEMINISTRIT	GETO NVO	2,000.00
30	ZYRA E KRYEMINISTRIT	GRACANICA YOUTH INITIATIVES	9,000.00
31	ZYRA E KRYEMINISTRIT	GREEN ZONE	4,000.00
32	ZYRA E KRYEMINISTRIT	H LIFE	4,000.00
33	ZYRA E KRYEMINISTRIT	INICIATIVA ZA RAZVOJ IZRAZ	8,000.00
34	ZYRA E KRYEMINISTRIT	JETA BURON	780.00
35	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KDN OJQ	2,000.00
36	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KGBD	20,000.00
37	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KKAFZHK	9,600.00
38	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KLUTURNI KLUB GRACANICA KKG	1,000.00

39	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KMDLNJ	9,900.00
40	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KORI I BURRAVE-GJAKOVE	1,000.00
41	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KSHILLI RIONOR I RAHOVECIT	5,800.00
42	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KULTURNO UMETNICKO DRUSTVO SAR	20,000.00
43	ZYRA E KRYEMINISTRIT	KV DRENICA	5,000.00
44	ZYRA E KRYEMINISTRIT	LIDHJA RINORE BLUE	4,000.00
45	ZYRA E KRYEMINISTRIT	MANASTIR DRAGANAC	2,000.00
